

RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË KUVENDIN E MAQEDONISË

Një dokument i shkurtër mbi politikën publike

Ilina Mangova

Shënime nga autorja

Gjatë të shprehurit në gjuhën maqedonase pothuajse ekskluzivisht kur flasim për personin e tretë njëjës (ose shumës), entitet i panjohur, subjekt, "veprues" I ndonjë funksionu ose profesioni, ajo e trajton në gjininë mashkullore. Edhe pse gjuha maqedonase njih edhe gjininë mashkullore edhe femrore të emrave dhe përemrave, aq sa unë e di, gjatë shprehjes me shkrim apo me gojë zakonisht fjalitë formulohen në gjininë mashkullore ose asnjënjës, ose formulime dygjinore. Pra, media, hulumtimet dhe analizat flasin për "qytetarin", "ministrin", "presidentin", "gjyqtarin", "shefin" dhe jo për "qytetaren", "ministren", "presidenten", "gjyqtaren", "shafen." Kjo praktikë dhe traditë në mënyrë të pandërgjegjshme krijon perceptimin e personave të gjinisë mashkullor, në vend se të krijohen mundësi të barabarta që persona edhe të gjinisë femrore edhe të asaj mashkullore të perceptohen në pozicione të tilla apo të ngjashme.

Ky diskriminim gjinorë subtil dhe i pa vërejtshëm i konstituuar në gjuhën maqedonase, folësve të gjuhës maqedonase në mënyrë të pandërgjegjshme u imponon botëkuptim të parë përmes prizmes së gjinisë mashkullore. Si rrjedhojë, botëkuptimi përmes kësaj prizme të gjuhës ndikon në identifikimin ose joidentifikimin e anëtarëve të gjinive të ndryshme dhe roli dhe funksioni i tyre në sferën publike apo pozitave publike.

Ky dokument për politikën publike ndërpret këtë traditë të gjinisë dhe gjuhës dhe personin e panjohur e trajton ekskluzivisht në gjininë femërore. Kjo qasje vërehet edhe në gjuhën angleze, ku ka shumë vite që aplikohet në të shprehurit akademik në gjuhën angleze. Unë shpresoj se ky dokument për politikën publike do të stimulojë që kjo qasje të zbatohet gjithnjë e më shumë në fjalën e shkruar maqedonase.

Unë shpresoj se leximi nuk do të shkaktojë disonancë kognitive.

Me respekt,

Ilina Mangova

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
I. Modelet dhe praktikat për pjesëmarrjen e publikut në punën e Kuvendit të Maqedonisë	3
I.1 Kontaktet në mes të deputetëve dhe qytetarëve	3
I.2. Pjesëmarrja në seancat e komisioneve	4
I.3. Diskutimi publik.....	5
I.4. Seancat e këshillit mbikëqyrës	5
I.5. Dëgjimi publik	6
I.6. Përfshirja pasive e publikut	6
I.6.1 Kanali televiziv parlamentar	7
I.6.2 Kanali në Youtube	7
I.6.3. Pjesëmarrja në seancë plenare dhe Ditë e hapur për qytetaret	7
I.6.4. Komunikimi me publikun përmes mediave sociale - Facebook dhe Twitter.....	7
I.6.5. E-gazeta e Kuvendit.....	8
II. Modele të tjera të pjesëmarrjes - praktikat e parlamenteve të tjera në Evropë	8
II.1. Kontakti me deputetet.....	8
II.2. Peticione publike – Dhoma e Ulët në Mbretërinë e Bashkuar	8
II.3. E-peticione – Dhoma e Ulët në Mbretërinë e Bashkuar.....	9
II.4. Agora Qytetare: lidhja e parlamentit evropian me shoqërinë civile evropiane	10
II.5. Thirrje e hapur për të dhëna.....	10
II.6. Vizitë dhe monitorim i Parlamentit.....	11
III. Konkluzionet	11
IV. Rekomandime për Kuvendin e Maqedonisë për përmirësimin e pjesëmarrjes së publikut në punën e saj.....	11

HYRJE

Parlamenti kryen tri funksione kryesore: funksionin ligjvënës, mbikëqyrjen mbi punën e ekzekutivit dhe përfaqësimin e qytetareve. Në zgjedhjet parlamentare qytetaret zgjedhin përfaqësueset e tyre që ti përfaqësojnë ato në çështje me rëndësi kushtetuese, në mbikëqyrjen e autoriteteve qeveritare dhe miratimin e ligjeve gjatë mandatit të tyre. Megjithatë, e drejta dhe mundësia e qytetareve të përfaqësohen, të marrin pjesë dhe ndikojnë në vendimmarrjen dhe punën e Kuvendit mbaron në ditën e

zgjedhjeve. Demokraci nënkuton dhe u ofron qytetareve ofron mënyra të shumta për të marrë pjesë dhe për të ndikuar në sjelljen e ligjeve, krijimin e politikave publike dhe punën e përfaqësueseve të tyre në kohën mes dy zgjedhjeve. **Mënyrat zyrtare dhe jozyrtare me të cilat qytetaret me kapacitetin e tyre individual ose përmes organizatave të shoqërisë civile, të kërkojnë që deputetet të veprojnë në kuadër të mandatit të saj, mund të përkufizohen si pjesëmarrje në punën publike të Parlamentit.**

Ky dokument i politikës publike harton mundësitë e tanishme për pjesëmarrje në punën publike të Kuvendit të RM-së dhe prezenton konstatime se si ato praktikohen. **Nën publik nënkuptohet çdo qytetar, shoqatë qytetare apo ndonjë pale tjetër e interesuar që nuk është as përfaqësuese, e as punon në Kuvend. Nën Kuvend nënkuptohet veprim individual i deputeteve ose si një trup kolektiv në seanca plenare apo mbledhjet e trupave punuese.** Më tej, ky dokument i politikës publike paraqet modele të tjera të suksesshme të pjesëmarrjes së publikut në punën e parlamentit që praktikohet në vendet evropiane, kryesisht në Dhomën e Ulët të Mbretërisë së Bashkuar dhe Parlamentit Evropian. Ky dokument i politikës publike rekomandon që edhe në Maqedonië të futen këto metoda për pjesëmarrjen e publikut në punën e Kuvendit. Kështu Kuvendi maqedonas do të sigurojë qasje më të madhe për qytetarët në vendimmarrje, do të përmirësojë rolin e saj përfaqësues dhe do të demokratizoj punën e saj, krijimin e ligjeve dhe politikave.

I. MODELET DHE PRAKTIKAT PËR PJESËMARRJEN E PUBLIKUT NË PUNËN E KUVENDIT TË MAQEDONISË

Ky seksion paraqet modelet dhe të dhënat në dispozicion për praktikën aktuale të pjesëmarrjes së publikut në punën e Kuvendit të Maqedonisë.

I.1 KONTAKTET NË MES TË DEPUTETËVE DHE QYTETARËVE

Qytetarët maqedonase kanë pak mundësi për të ndikuar në punën e Kuvendit. Si pjesë e detyrave të saj si një deputete, deputetja është e detyruar që midis të tjerash, “të ketë kontakte me qytetarët, kontakte dhe konsultime me OJQ-të, kontakte,

bashkëpunim dhe konsultim me Sindikatin dhe shoqatat e qytetarëve”.¹ Këto kontakte mund të themelohen dhe mbahen në kuadër të Kuvendit ose në Zyrën për kontakt me qytetarët në zonën e saj, të cilën duhet ta ofroj komuna. Webfaqja e Kuvendit të Maqedonisë përmban një hartë me të gjitha zyrat për kontakt me qytetarët gjat gjithë vendit, ku qytetarët mund të gjejnë se ku ndodhet ajo zyrë në komunën e tyre, cilat deputete të cilës parti politike mund të gjenden përmes asaj zyre, cili është orari i tyre i punës dhe numri i telefonit përmes të cilit mund të kontaktojmë me zyrën.²

Për më tepër, çdo e premtë është caktuar si ditë që deputetet duhet ta kushtojnë për kontakte me qytetarët dhe votuesit në zonën e saj zgjedhore. Prandaj, me përjashtim të emergjencave, në përgjithësi Kuvendi dhe trupat punuese nuk mbajnë seanca apo aktivitete të tjera në këtë ditë. Resurset për këtë qëllim janë siguruar nga buxheti i Kuvendit.

Në webfaqen e Kuvendit gjithashtu gjenden **adresat elektronike dhe numrat e telefonit të shumicës së deputeteve**, por jo detajet e kontaktit të të gjitha grupeve parlamentare, apo individualisht për deputetet.³ “Pyetni deputetin”⁴ do të thotë se pala e interesuar mund të shkruan pyetjen dhe mesazhin e tyre në formularin e kontaktit në faqen e internetit. Gjatë përbërjes parlamentare 2011-2014, mund të gjindeshin adresat elektronike të të gjitha deputeteve, që nuk është rast më tek deputetet e zgjedhura në vitin 2014. Përveç

¹ Ligji për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.104/2009

² Kuvendi i Republikës së Maqedonisë zyrat për kontakt me qytetarët, në dispozicion në: <http://www.sobranie.mk/kancelarii-za-kontakt-sograganite-map.nspix>

³ Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Kontaktet - grupeve parlamentare, në dispozicion në: <http://www.sobranie.mk/pratenicki-grupi.nspix>

⁴ Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Pyete deputetin, në dispozicion në: <http://www.sobranie.mk/prashaj-go-pratenikot.nspix>

kësaj, Kuvendi ka emëruar kontakt person për komunikim me qytetaret që kanë ndonjë lloj dhe shkallë të aftësisë së kufizuar.⁵

Megjithatë, një sondazh i kryer nga Instituti Ndërkombëtar Republikan në qershor të vitit 2015 ka konstatuar se vetëm 6% e qytetareve thonë se kanë qenë të kontaktuara nga një deputete në 12 muajt e fundit.⁶ Pak më shumë qytetare, 9% thanë se ishin të kontaktuara nga një deputete. Në mesin e atyre që kontaktuan me deputete, 3% kishte kontaktuar përmes një mikeje personale në vend neutral, 2% me telefon, 2% në kontakt zyren për qytetaren, dhe vetëm 1% në zyrën e Kuvendit, përmes zyrës së Kuvendit apo përmes punonjësës në Zyrën për kontakt me qytetarët në të gjithë vendin.⁷ Ndërkohë, një tjetër sondazh i kryer nga Instituti për Demokraci "Societas Civilis"-Shkup (IDSCS) në maj dhe qershor të vitit 2015⁸ konstatoi se një e treta e të anketuarve kanë përshtypjen se deputetet janë në dispozicion, dhe një përqindje më e lartë, 49%, gjysma e të anketuarve kanë përshtypje se Kuvendi nuk është i hapur për publikun, ndërsa 41% mendojnë të kundërtën. Së fundi, qytetarët mendojnë se mënyra më e rëndësishme përmes së cilës deputetet do të jenë më efikase në kryerjen e punës së tyre është të komunikojnë më shpesh me qytetarët dhe OJQ-të. Kjo është përgjigja më e shpeshtë (41%) e 6 përgjigje të mundshme

për pyetjen se si deputetet mund të kryejnë punën e tyre në mënyrë më efikase.⁹

Qytetarët mund të propozojnë ligje të reja nëpërmjet propozuesve të autorizuar - deputet, Qeverisë dhe minimum 10.000 votues (0.45% e popullsisë në Maqedoni).¹⁰ Qytetarja këtë mund ta bëjë këtë në mënyrë individuale, në grup ose përmes ndonjë shoqate të qytetarëve. Nëse një qytetare apo grup qytetarësh arrijnë të bindin ndonjë deputete ose grup deputetesh të propozojnë ndonjë ligj emër të tyre, atëherë, më vonë në proces një deputet ose deputete e atij grupi bëhet përfaqësuese e atij/asaj që e ka dhënë propozimin.

Megjithatë, pavarësisht nga mundësia kushtetuese, një nga hulumtimet e mësipërme anketuese zbuloi se vetëm një e katërta e popullsisë (26%)¹¹ thonë se dinë se si të ngritin iniciativë për ndonjë ligj të ri apo amandman tek propozuesit e autorizuar, që do të thotë se shumica nuk janë në dijeni për të drejtat dhe mundësitë e tyre për të ndikuar në vendimmarrje përmes kësaj mënyre.

I.2. PJESËMARRJA NË SEANCAT E KOMISIONEVE

Në Kuvendin maqedonas punojnë 21 komisione dhe ato mund të përfshijnë publikun në seancat e tyre të rregullta apo në mbikqyrjet dhe diskutimet publike.

⁵ Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Kontakt persona, në dispozicion në:

<http://www.sobranie.mk/kontakt-lica.nspk>

⁶ Anketa e opinionit publik në Maqedoni. Instituti Ndërkombëtar Republikan, korrik 2015 në dispozicion në:

<http://www.iri.org/sites/default/files/wysiwyg/2015-07->

[13_survey_of_macedonian_public_opinion_june_6-15_2015.pdf](http://www.iri.org/sites/default/files/wysiwyg/2015-07-13_survey_of_macedonian_public_opinion_june_6-15_2015.pdf)

⁷ Ibid.

⁸ Opinioni publik mbi punën e Kuvendit. Instituti, për Demokraci Societas Civilis "- Shkup, qershor 2015 në dispozicion në:

http://idscs.org.mk/images/parliament-watchdog/Sobranieto_pod_lupa-Vtora_terenska_anketa_za_rabotata_na_Sobraniet_o.pdf

⁹ Opinioni publik mbi punën e Kuvendit. Instituti,, për Demokraci Societas Civilis "- Shkup, qershor 2015 në dispozicion në:

http://idscs.org.mk/images/parliament-watchdog/Sobranieto_pod_lupa-Vtora_terenska_anketa_za_rabotata_na_Sobranieto.pdf

¹⁰ Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në dispozicion në: <http://www.sobranie.mk/the-constitution-of-the-republic-of-macedonia.nspk>

¹¹ Opinioni publik mbi punën e Kuvendit. Instituti,, për Demokraci Societas Civilis "- Shkup, qershor 2015 në dispozicion në:

http://idscs.org.mk/images/parliament-watchdog/Sobranieto_pod_lupa-Vtora_terenska_anketa_za_rabotata_na_Sobraniet_o.pdf

Trupat punuese të Kuvendit mund të ftojë palët e interesuara si ekspertë dhe përfaqësues të institucioneve shkencore, institucioneve publike, shoqërisë civile, pushtetit vendor dhe organizatave të tjera për të shprehur pikëpamjet e tyre mbi çështjet e diskutuara në komision. **Organizatave e shoqërisë civile mund të inicojnë diskutim në trupat punues të Kuvendit, por një qytetare nuk mundet.**¹² Nëse një qytetare dëshiron të ngrejë një çështje të veçantë në një trup punues, ajo duhet ta bëjë këtë përmes shoqërisë civile, gjë e cila e kufizon qytetaren për të marrë pjesë në krijimin e politikës dhe të jenë të përfshira në mënyrë aktive në politikë me kapacitetin e saj individual qytetar.

Përderisa ky lloj i pjesëmarrjes publike mund të behen gjatë seancave të rregullta të komisioneve apo diskutimeve publike ose mbikëqyrëse të organizuara nga komisionet, nuk ka udhëzime se si shoqëria civile të inicojë kësi lloj diskutimi. Kjo lë hapësirë për paqartësi se si nisma të tilla do të trajtohen nga komisionet dhe mundësi për qajsje jo të unifikuar drejt këtij lloji të iniciativave nga ana e kryetarëve të komisioneve.

I.3. DISKUTIMI PUBLIK

Mënyrë më përfshirëse dhe më e hapur për pjesëmarrjen e publikut në punën e Kuvendit gjatë pregaditjes së ndonjë lighi është përmes diskutimit publik.” Për projektligjin, i cili është me interes më të gjerë, Kuvendi pas diskutimit të përgjithshëm, mund të vendosë që për atë ligji të mbahet diskutim publik dhe të përcaktojë një trup punues amë, që do ta organizon debatin publik.”¹³ Trupi punues duhet të sigurohet që propozim ligji të

¹² Rregullorja e Punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, teksti rishikuar. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në dispozicion në:

<http://www.sobranie.mk/delovnik-na-sobranieto-na-republika-makedonija-precisten-tekst.nspk>

¹³ Rregullorja e Punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, teksti rishikuar. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në dispozicion në:

<http://www.sobranie.mk/delovnik-na-sobranieto-na-republika-makedonija-precisten-tekst.nspk>

publikohet dhe të vihet në dispozicion, mes të tjerash, për qytetaret, shoqatë qytetare dhe aktorëve të tjerë. Teksti i propozim-ligjit publikohet në gazetata e përditshme së bashku me thirrjen për propozime dhe qëndrime. **Çdo qytetare, shoqatë qytetare ose përfaqësues tjetër mund të marrin pjesë në diskutim publik.** Trupi punues i mbledh dhe i sintetizon propozimet dhe qëndrimet e shprehura gjatë diskutimit dhe është i detyruar të përgatisë një raport mbi to. Më pas, raporti do t'i paraqitet Kuvendit në fazën e dytë të leximit.

Webfaqja e Kuvendit ka njoftuar për diskutim publik për vetëm 5 projektligje në periudhën kohore mes vitit 2008 dhe 2015, ndërsa në këtë periudhë kohore Kuvendi ka punuar mbi 3398 ligje.¹⁴ Kjo është shumë pak dhe tregon një nivel të ulët të përfshirjes së publikut në krijimin e politikës dhe vendimmarrjes.

I.4. SEANCAT E KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Seancat mbikëqyrëse kanë për qëllim të sigurojnë komisionit informacione dhe ekspertizë në kuadër të punës së saj dhe në lidhje me zbatimin e politikave publike nga ana e Qeverisë apo organeve të tjera të administratës. Përveç nga zyrtarët e qeverisë, Komisioni mund të ftojë edhe persona tjerë

¹⁴Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Diskutime publike, në dispozicion në: <http://www.sobranie.mk/javni-diskusii.nspk> ; *Raporti Vjetor i Kuvendit në periudhën e 10.05 / 2014 - 31.10 / 2014th Parlamenti maqedonas, në dispozicion në:* <http://www.sobranie.mk/javni-diskusii.nspk> ; <http://www.sobranie.mk/content/izvestai/2011-2014/IZVESTAJ%202014%2010.05%20-%2031.12.2014.pdf> ; Raporti i përbërjes shtatë parlamentare të Parlamentit në periudhën 25.06.2011 - 05.03.2014, në dispozicion në: <http://www.sobranie.mk/content/izvestai/2011-2014/Mandaten%20izvestaj%207%20osostav%202011-2014.pdf> ; *Raporti i përbërjes së gjashtë parlamentare e Kuvendit në periudhën 2008/06/21 - 14.05.2011, në dispozicion në:* <http://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/MANDATENIZVESTAJ08nukoregiran.pdf>

për të paraqitur konstatimet e tyre mbi çështjet që janë duke u diskutuar. Seancat mbikëqyrëse janë të kufizuara për ata persona të cilët janë të ftuar. Kuvendi informon për seancat mbikëqyrëse përmes webfaqes së saj dhe kanalit televiziv parlamentar. Që nga viti 2008, një periudhë prej 7 vitesh, janë organizuar në total 10 debate mbikëqyrëse. Pesë janë organizuar gjatë përbërjes parlamentare 2008-2011, dhe pesë në periudhën 2011-2014 dhe asnjë në vitin 2014.¹⁵

I.5. DËGJIMI PUBLIK

Dëgjimi publik është seancë publike e komisionit, ku komisioni mbledh konstatimet, analiza dhe informacione të tjera nga aktorë të jashtëm dhe në këtë mënyrë rrit rëndësinë e ndonjë çështjeje, parqitet si e re, ose përmirësim i ndonjë politike publike. Megjithatë, edhe pse praktikohet nga disa komisione, debati publik nuk rregullohet nga Ligji për Kuvend, e as nga Rregullorja e Punës së Kuvendit. Në praktikë, organizimi i dëgjimeve publike varet nga vullneti i mirë i kryetareve të komisioneve.

Ndërmjet viteve 2008 dhe 2014 në përbërje të ndryshme parlamentare janë organizuar 55 dëgjime publike nga 12 komisione parlamentare. Përderisa një pjesë e komisioneve kanë qenë shumë aktive në organizimin e dëgjimeve publike, 8 komisionet nuk kanë organizuar asnjë dëgjim publik. Më sakt, në vitin 2014, 10 dëgjime publike u organizuan nga pesë komisione.¹⁶ Në periudhën kohore 2011-2014, 31 dëgjime publik u organizuan nga nëntë komisione, nga të cilat 11 janë të organizuara nga Komisioni për Mundësi të Barabarta të Femrave dhe Meshkujve e udhëhequr nga

Liljana Popovska.¹⁷ Në përbërjen parlamentare nga viti 2008 deri në vitin 2011, 14 dëgjimet publike u organizuan nga 7 komisione.¹⁸ Në praktikë, shumica e dëgjime publike janë të kufizuara në ato që ishin të ftuar në seancë, që do të thotë se ato nuk janë plotësisht publike dhe përfshirëse. Në anën tjetër, disa komisione, të tilla si Komisioni për Mundësi të Barabarta të Femrave dhe Meshkujve, shpalli publikisht dëgjime publike dhe të ishin të hapura për çdo qytetare apo veprues tjetër të interesuar për të marrë pjesë.

Këto të dhëna tregojnë se shumica e kryetareve të komisioneve nuk kanë njohur nevojën për të organizuar debate publike si një mënyrë për të forcuar kontaktet e tyre me njohuri dhe informacion jashtë kuvendit dhe nuk njohur nevojën për të rritur rëndësinë e publikut në vendimmarrje.

I.6. PËRFSHIRJA PASIVE E PUBLIKUT

Shpërndarja e informacioneve në lidhje me Kuvendin është e rëndësishme për qytetaret të jenë të njoftuara me punën e tij, se si ai funksionon, se si debaton mbi ligjet dhe se si i miraton ato. Qytetarja e informuar është një parakusht i domosdoshëm për demokracinë dhe çdo lloj i pjesëmarrjes qytetare. Prandaj, çdo lloj informacioni publik për Kuvendin, madje edhe kur nuk përfshin pjesëmarrjen e qytetareve, është kritike për të siguruar bazën për pjesëmarrje të mundshme në vendimmarrje. Ky seksion paraqet modele nëpërmjet të cilave publiku maqedonas mund të informohen për punën e Kuvendit drejtpërdrejt nga Kuvendi.

¹⁷ Raporti i përbërjes shtatë parlamentar të Parlamentit në periudhën 25.06.2011 - 05.03.2014. Parlamenti maqedonas, në dispozicion në: <http://www.sobranie.mk/content/izvestai/2011-2014/Mandaten%20izvestaj%207%20sostav%202011-2014.pdf>

¹⁸ Raporti i përbërjes shtatë parlamentar të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në periudhën prej 25.06.2011 - 05.03.2014. Parlamenti maqedonas, në dispozicion në: <http://www.sobranie.mk/content/izvestai/2011-2014/Mandaten%20izvestaj%207%20sostav%202011-2014.pdf>

¹⁵ Ibid.

¹⁶ Raporti Vjetor i Kuvendit në periudhën e 10.05 / 2014 - 31.10 / 2014th Parlamenti maqedonas, në dispozicion në: <http://www.sobranie.mk/content/izvestai/2011-2014/IZVESTAJ%202014%2010.05%20-%2031.12.2014.pdf>

1.6.1 KANALI TELEVIZIV PARLAMENTAR

Qytetaret mund të ndjekin çdo seancë plenare në kanalin televiziv parlamentar. E njëjta gjë vlen edhe për seancat e komisioneve, këshillave dhe organeve të tjera parlamentare. Kanali televiziv parlamentar është i garantuar me Ligjin për Kuvend, si kanal “që informon dhe edukon qytetarët për jetën politike, nëpërmjet programeve parlamentare, arsimore dhe qytetare.”¹⁹ Më tej, thuhet se kanali televiziv duhet të transmetoj programe që do të kontribuojnë për socializimin dhe kohezionit ndëretnik, do të luftoj kundër diskriminimit dhe do të pasqyroj diversitetin shoqëror. Në mënyrë të ngjashme, duhet të siguroj barazi politike dhe përfaqësim të barabartë të gjuhëve në programet e tyre. Kanali parlamentar është i financuar nga Kuvendi dhe e udhëheq Këshilli Parlamentar I cili është i përbërë nga deputete të partisë qeverisëse dhe opozitare.

1.6.2 KANALI NË YOUTUBE

Kuvendi i Maqedonisë gjithashtu ka kanalin e tij official YouTube. Megjithatë, edhe pse të gjitha seancat plenare dhe komisioneve janë të regjistruara, ato nuk transmetohen në kanalin YouTube. Vetëm shtatë video në lidhje me Kuvendin janë ndarë në këtë kanal.²⁰

1.6.3. PJESMARRJA NË SEANCË PLENARE DHE DITË E HAPUR PËR QYTETARET

Një qytetare mund të marrë pjesë dhe të përcjell ndonjë seancë të Kuvendit dhe trupave të tij punuese nga galeritë në amfiteatrin kuvendor,²¹ por kjo është e

rregulluar nga procedurat e brendshme të Kuvendit, dokument i cili nuk është publik. Nga të gjitha informatat në dispozicion, nuk ka dëshmi se ndonjë qytetare ka përcjell ndonjë seancë parlamentare brenda Kuvendit.

Në prill të vitit 2015, Kuvendi e reinstitucionalizoi praktikën e Ditëve të hapura për vizita nga qytetaret, që mbahet çdo të premten e fundit të muajit. Kjo praktikë u prezantua për herë të parë nga kryetari i Kuvendit Ljupço Jordanovski në vitin 2005,²² por u ndërpre më pas nga kryetari i ardhshëm i Kuvendit Ljubisha Georgievski.²³ Kryetari i tanishëm i Kuvendit, Trajko Veljanoski i riktheu në praksë Ditët e hapura të Kuvendit. Në periudhën nga prilli deri në tetor, 2015, pas renovimit të ndërtesës së Kuvendit, ka pasur 1182 vizitorë. Megjithatë, në këto vizita qytetaret njoftohen vetëm me arkitekturën e ndërtesës dhe hapësirat ku përfaqësuesit e tyre punojnë dhe sjellin ligje dhe ende nuk mund të marrin pjesë personalisht në seancat plenare.

1.6.4. KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN PËRMES MEDIAVE SOCIALE - FACEBOOK DHE TWITTER

Kuvendi i Maqedonisë ka llogarinë e saj në Twitter dhe Facebook, ku publikon seancat dhe informacione në lidhje me seancat. Këto dy profile nuk janë të sinkronizuara plotësisht dhe profili Twitter, twitter.com/SobranieMK me 101 ndjekës,²⁴ është më aktiv. Profili i Facebook-ut www.facebook.com/SobranieRM_Facebook ka më shumë ndjekës, 2534, por publikon më

¹⁹ Ligji për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Gazeta Zyrtare, nr. 104/2009

²⁰ Numrat janë të vlefshme deri më 10 tetor, 2015. kanal parlamentar YouTube mund të gjenden në linkun e mëposhtëm:
<https://www.youtube.com/channel/UCD5qpVeg-yNv4Xu4b3EuKfW/videos>

²¹ Numrat janë të vlefshme deri më 10 tetor, 2015. kanal parlamentar YouTube mund të gjenden në linkun e mëposhtëm:

<https://www.youtube.com/channel/UCD5qpVeg-yNv4Xu4b3EuKfW/videos>

²² Vest, Urdhëroni në shtëpinë tonë, 5.10.2005
<http://star.vest.com.mk/default.asp?id=96767&idg=5&idb=1459&rubrika=Makedonija>

²³ Utrinski Vesnik, Kryetari Georgievski e mbylli parlamentin për qytetarët, 25.04.2007
<http://vesnik.mk/?ItemID=201E1DA906CAA4687E2CE7C2CCB6212&commentID=25513&pLikeVote=0>

²⁴ Numri i ndjekësve në Facebook dhe Twitter, më datën 10 tetor 2015

pak njoftime dhe informacione sesa profilin në Twitter. Të dy profilet e mediave sociale ofrojnë të dhëna bazë por nuk ndajnë informacione më të detajuara rreth Kuvendit, structures së tij, kush janë deputetet, fjalimet gjatë seancave, më shumë informacion të detajuara mbi amandamentet, argumenteve të ngritura në diskutim, apo detaje të tjera.

1.6.5. E-GAZETA E KUVENDIT

Çdo person i cili dëshiron të jetë i informuar për axhendën e Kuvendit mund të kërkojë E-gazetën e Kuvendit.²⁵ E-gazeta e Kuvendit informon mbi axhendën e Kuvendit, për seancat plenare dhe të komisioneve, si dhe aktivitetet e rëndësishme të Kuvendit dhe deputeteve.

II. MODELE TË TJERA TË PJESËMARRJES - PRAKTIKAT E PARLAMENTEVE TË TJERA NË EVROPË

II.1. KONTAKTI ME DEPUTETET

Disa parlamente evropiane publikisht, në webfaqet e tyre, publikojnë adresat elektronike të deputeteve që ju jep mundësi qytetareve që më lehtë t'i kontaktojnë ato. Ky është rasti me parlamentin e Sllovakisë, Mbretërisë së Bashkuar, Holandës, Danimarkës, Suedisë, dhe Spanjës, si dhe disa parlamenteve të tjera. Deputetet e Mbretërisë së Bashkuar gjithashtu publikojnë numrin e telefonit të zyrës së tyre, ndërkohë që disa deputete nga Danimarka publikojnë edhe numrin e telefonit të tyre celular. Parlamentet tjera, si Bundestagu gjerman, u sigurojnë kontakt qytetareve me deputetet përmes një formulari online për kontakt.

²⁵ Aplikimi për marrjen e e-gazetës parlamentare është e vendosur në linkun e mëposhtëm: <http://www.sobranie.mk/newsletter.n.spx>

II.2. PETICIONE PUBLIKE – DHOMA E ULËT NË MBRETËRINË E BASHKUAR

Banorët e Mbretërisë së Bashkuar mund të dërgojnë kërkesë në Dhomën e Ulët të Mbretërisë së Bashkuar përmes peticionit (letrës) publik.²⁶ Ka një gamë të pyetjeve në lidhje me çfarë mund të kërkohej përmes një peticioni. Është e rëndësishme që në peticion të jetë e shënuar qartë pyetja e cila i shqetëson qytetaret dhe dhe për të cilën kërkojnë që Dhoma e Ulët të veprojë ose të kërkojë nga Qeveria që të veprojë. Peticion publik mund ta paraqesë një qytetare dhe kjo ndodh shpesh.²⁷

Pasi të jetë ngritur një peticion publik mund të paraqitet në Dhomën e Ulët në mënyrë formale apo joformale vetëm nga ana e deputeteve, por ato nuk janë të detyruara ta bëjnë këtë. Prezantimi zyrtar do të thotë se deputetja përfaqëson peticionin personalisht, komunikon se kush dhe sa persona parashtrajnë peticion, çka kërkohej dhe pastaj lexon tekstin e peticionit. Siç kërkohej nga procedura, atëherë deputetja duhet të vënë peticionin në tryezë, atëherë nëpunësi e lexon titullin e peticionit dhe në fund deputetja vë peticionin në dosje dhe kërkesa konsiderohet se është ngritur. Është e nevojshme të plotësohen disa kriteret që një deputete ta paraqet ndonjë peticion në Dhomën e Ulët. Së pari, ajo duhet të jetë e adresuar për Dhomën e Ulët, duhet të jetë shkruar qartë se si kërkohej nga Dhomën e Ulët për të veprojë ose çfarë presin nga Dhomën e Ulët të kërkojë nga Qeverisë.

Secili peticion i paraqitur publikohet në raportet zyrtare dhe gazetën zyrtare të Parlamentit dhe pastaj dorëzohet në

²⁶ Dhoma e Ulët, Mbretëria e Bashkuar, Peticione Publike, në dispozicion në: <http://www.parliament.uk/get-involved/have-your-say/petitions/paper-petitions/>

²⁷ Dhoma e Ulët, Mbretëria e Bashkuar, Zyra e shtypit e Dhomës së Ulët, peticione publike, në dispozicion në: <http://www.parliament.uk/documents/commons-information-office/Po7.pdf>

Departamentin e Qeverisë përgjegjës për trajtimin e peticioneve dhe të përgjigjet brenda dy muajve. Komisioni për Peticione mund gjithashtu të rekomandojë procedura shitesë për peticione të caktuara.

Webfaqja e Dhomës së ulët në Mbretërinë e Bashkuar jep udhëzime të hollësishme se si të përgatitet peticioni. Për më tepër, në qoftë se qytetaret kanë nevojë për ndihmë në përpilimin e kërkesës ka në dispozicion punonjëse publike për peticione e cila u ndihmon qytetareve në hartimin e peticionit, detajet e kontaktit të së cilës janë gjithashtu në dispozicion në webfaqe.²⁸

II.3. E-PETICIONE – DHOMA E ULËT NË MBRETËRINË E BASHKUAR

"Publiku tashmë ka shumë mundësi që zëri i saj të dëgjohet në Parlament, dhe ky sistem i ri i e-peticioneve mund të jep edhe një megafon." - deputeti Sër Xhorxh Jang, Dhoma e Ulët në Mbretërinë e Bashkuar

Qytetaret britanike dhe banoret e Mbretërisë së Bashkuar mund të fillojë një peticion online për të thirrur për ndryshimin e ndonjë ligji ose politike të qeverisë.²⁹ Nëse edhe një peticion online mbledh 10,000 nënshkrime (0.015% e popullsisë britanike), Qeveria i përgjigjet peticionit, dhe në qoftë se mbledhen 100,000 nënshkrime (0.15% e popullsisë britanike), peticioni duhet të merret parasysh në debat në Parlament. Kjo është bëhet përmes webfaqes zyrtare petition.parliament.uk. Kur të filloni një peticion, është e nevojshme të mirrni mbështetje fillestare nga pesë persona, dhe nëse peticioni i plotëson standardet e nevojshme do të publikohen në internet, ndërsa parashtruesja do të informohet se si

do të vazhdon procedura më tej. Komisioni për Peticione është i përbërë nga 11 deputete nga partitë qeverisëse dhe opozitare dhe është përgjegjës për shqyrtimin dhe përpunimin e peticioneve të paraqitura, në mënyrë që peticionet shqyrtohen në nivel të lartë politik.

Peticionet online janë të hapura për nënshkrimin deri më 6 muaj. Komisioni për Peticione gjithashtu kanë autoritet të bëjnë shtypje mbi Qeverinë apo Parlamentin të veprojnë mbi çështjet e ngritura në peticion. Në rast se një çështje e veçantë është diskutuar kohët e fundit në Kuvend apo në rendin e ditës për diskutim, peticioni do të ngritet për tu dëgjuar si një çështje e veçantë. Përveç kësaj, deputetet kanë pasur mundësi për të hapur debat mbi peticionin para se të mbledhen 100,000 nënshkrime. **Komisioni për Peticione ndonjëherë fton praqitëset e peticionit në diskutim me deputetet apo ministreshat e qeverisë apo të prezentojnë konstatimet e tyre në favor të peticionit përpara një Komisioni të zgjedhur.** Ky komision mund të zgjeroj konsultimin duke ju drejtuar për konsultim organizatave apo individëve për tu këshilluar mbi çështjen e ngritur në peticion.

Jo çdo peticion iniciuar do të publikohet në internet. Që një peticion të dalë do të duhet të përmbush disa standarde: duhet të jetë e qartë se çfarë kërkohet; duhet të kërkojë diçka që është përgjegjësi e Qeverisë apo Parlamentit; duhet të ket të bëj me qështje publike, e jo private; të mos jetë çështje konfidenciale; të ket respekt; të mos jetë fyese, j të mos provokoj, të mos jetë ekstreme dhe nuk e përmend gabimisht, të mos reklamoj, e as të bëj shaka me ndonjë çështje të caktuar; nuk mund t'i referohet politikave partiake dhe duhet të plotësojnë edhe disa kritere të tjera specifike për vendin. Nëse peticioni refuzohet, Komisioni për Peticione do të informojë parashtruesin e peticionit për arsyet se pse kërkesa i është refuzuar dhe do të ofrojë këshilla për ndonjë mënyrë tjetër për të ngritur atë çështje.

²⁸ Peticion me përkrahjen më të madhe publike në Mbretërinë e Bashkuar me 4.5 milion nënshkrime për Peticionin për kujdesin shëndetësor parësor, Sindikata kërkonte dhe arriti paga më të larta dhe kushte më të mira pune për stafin në kujdesin parësor.

²⁹ Qeveria dhe Parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar, Peticione - <https://petition.parliament.uk/>

Megjithatë, përveç nëse peticionet e refuzuara janë të paligjshme, tekstet e tyre publikohen në web faqen e peticioneve.

Të gjitha udhëzimet për paraqitjen e peticionit janë postuar në faqen e internetit për peticionet. Natyrisht, të gjithë individët e interesuar mund të bëjnë pyetje të detajuara përmes e-mail adresës, telefon ose telefon me tekst për personat me aftësi të kufizuar të dëgjimit. Deri më 11 tetor 2015, janë paraqitur 2055 e-peticione në faqen zyrtare për peticione. Deri më këtë datë, 1 295 prej këtyre peticioneve janë ende të hapura, asnjë nuk është mbyllur, 760 janë refuzuar, 30 kanë marrë përgjigje nga qeveria, 19 janë duke pritur përgjigje nga Qeveria, 4 janë duke pritur diskutim në Parlament, dhe për një tashmë është diskutuar në Parlament.

E-peticionet u prezantua fillimisht nga qeveria e Laburistëve në vitin 2006, megjithatë, web faqja u mbyll para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010. Faqen e tanishme të internetit për e-peticione e ka future në funksion qeveria Konservative, prezantuar në vitin 2011 si një përmbushje të programit të tij zgjedhor në mënyrë që të bëjë qeverinë më transparente dhe më të arritshme për qytetaret. Me rastin e promovimit të web faqes, udhëheqësi i Konservatorëve në Dhomën e Ulët, deputeti Sër Xhorxh Jang tha se hapja e web faqes „paraqet një hap tjetër drejt një parlamenti më transparent dhe më të arritshëm.”³⁰

II.4. AGORA QYTETARE: LIDHJA E PARLAMENTIT EVROPIAN ME SHOQËRINË CIVILE EVROPIANE

Agora Qytetare³¹ është një mekanizëm i strukturuar që e lidhën shoqërinë civile evropiane me Parlamentin Evropian (PE) në lidhje me çështjet më të rëndësishme në

agjendën e PE dhe që janë në interes të qytetareve. Agora është një forum në të cilin 500 përfaqësuese të organizatave të shoqërisë civile evropiane (OSHC) janë të ftuar për të diskutuar mbi një çështje të caktuar. Pesëqind përfaqësueset zgjidhen nga komisionet parlamnetare. Çdo diskutim në Agora moderohet nga dy moderatore, një deputete e Parlamentit European (PE), ose ndonjë institucion tjetër i BE-së dhe një nga ana e OSHC-ve.

Një OSHC mund të ketë vetëm një përfaqësues në Agora. Konferenca e Presidentëve (e cila përbëhet nga kryetarët e PE dhe kryetarët e grupeve politike) të përcaktojnë temat dhe kohën për diskutim. Agorës, që zgjat dy ditë, i presedojnë përgatitja e projekt dokumenteve. Përfaqësueset e zgjedhura të OSHC-ve, dy ose tre për puntori, kanë për detyrë të përgatisin dokument diskutimi para takimit, dhe përfaqësueset tjera të OSHC-ve janë të obliguara që të sigurojnë dokumente për diskutim nëpërmjet web faqes së Agorës. Pas Agorës, raportuesit përgatitin raporte ku paraqesin mundësitë që janë ofruar në çdo diskutim nga punëtorit.

Seancat e Agorës janë të institucionlizuara në Parlamentin Evropian, në nëntor të vitit 2007, kur u mbajt Agora e pare me titull „Ardhmëria e Evropës.” Me këtë mekanizëm, BE-ja ka shkuar shumë më përpara konsultimet e më mëparshme ad hoc shoqërinë civile dhe siguroi një kombinim të demokracisë së “drejtpërdrejtë” dhe “përfaqësuese” dhe në këtë mënyrë kontribuon në legjitimitet më të thellë të përfaqësueseve të zgjedhura nga qytetaret evropian.

II.5. THIRRJE E HAPUR PËR TË DHËNA

Parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar kërkon të dhëna, veçanërisht për të ndihmuar funksionin e vet të kontrollit mbi punën e

³⁰ Lajme BBC, deputetët debatuan kërkesat e një peticioni publik 29 korrik 2011, në dispozicion në: <http://www.bbc.com/news/uk-politics-14326218>

³¹ European Parliament, Agora <http://www.europarl.europa.eu/atyourservice/en/20150201PVL00041/Agora>

Qeverisë.³² Komisioni i zgjedhur nga Qeveria bën kërkesë publike për palët e interesuara të paraqesin gjetjet apo të dhënat që i posedojnë për ndonjë çështje specifike, dhe gjithashtu mund të ftojë funksionarë relevant të paraqesin të dhënat e tyre. Në të shumtën e rasteve, argumente e paraqitura, publikohen në web faqen e komisionit. Përveq kësaj, Komisioni pranon edhe konstatime gojore që ndodh publikisht.³³

II.6. VIZITË DHE MONITORIM I PARLAMENTIT

Disa parlamente evropiane janë të hapura çdo ditë dhe qytetarët mund të shikojnë seancat plenare nga galeria e parlamentit. Kjo është e mundur në parlamentet e Sllovakisë, Mbretërisë së Bashkuar, Holandës, Spanjës, Gjermanisë, Sllovenisë dhe vendeve të tjera. Kjo lejon më shumë njerëz për të vizituar Parlamentin. Për ilustrim, Bundestagu gjerman vë në dukje se ai u vizitua nga 39 milionë njerëz që kur u transferua nga Boni në Berlin.

III. KONKLuzionET

Parlamenti maqedonas ofron kanale të mira përmes të cilave publiku mund të marrin pjesë në punën e saj. Të interesuarit mund të kërkojnë të marrin pjesë në seancë të komisionit, dëgjimit publik ose të dëgjimit mbikqyrës, edhe pse kjo nuk është e përcaktuar qartë, publikuar ose inicuar. Të dhënat nga 7 vitet e fundit tregojnë se edhe pse frekuenca e dëgjimeve publike është rritur gjatë përbërjeve parlamentare që nga viti 2008, shumica e deputeteve nuk e ishin drejtuar drejt publikut përkatës që ajo të kontribuojë në diskutimin parlamentar. Pjesëmarrja e publikut në këtë mënyrë ofron gjetje, analiza, të dhëna dhe informacione të

³² Dhoma e Ulët, Mbretëria e Bashkuar, Hulumtime në komision: thirrje e hapur për argumente, në dispozicion në: <http://www.parliament.uk/business/committees/inquiries-a-z/current-open-calls-for-evidence/>

³³ Bundestagu gjerman, Vizitor, në dispozicion në: http://www.bundestag.de/htdocs_e/visits

tjera që mund të përmirësojnë cilësinë e legjislacionit dhe punën e deputeteve. Prandaj është e domosdoshme pjesëmarrja e publikut në debatet dhe diskutimet për ndryshimet në legjislacion dhe politikë të bëhet në mënyrë përfshirëse dhe të hapur në trupat punuese parlamentare.

Në mënyrë të ngjashme, edhe pse deputetet kanë mjaft të mjaftueshme, si mundësia të takohen me qytetarët në hapësirat e Kuvendit, në zyrat dhe në zyrat e caktuara për kontakt me qytetarët dhe dita e caktuar për takim me qytetarët në njësitë zgjedhore, hulumtimet tregojnë se vetëm një pjesë e vogël e qytetareve kanë pasur kontakt me deputetët.

Publiku i gjerë mund të informohet direkt për seancat përmes kanalit parlamentar, mediave sociale, e-gazetës. Nga ana tjetër, Kuvendi nuk e shfrytëzon kanalin e tij në YouTube, ku mund të publikojë regjistrimet e seancave.

Disa parlamente evropiane kanë krijuar mekanizma të suksesshme për pjesëmarrjen e publikut në punën e tij. Duke marrë parasysh këtë dokument për politikën publike rekomandon futjen e përmirësimeve dhe mënyrave të reja të pjesëmarrjes së publikut në punën e Kuvendit të Maqedonisë me qëllim të forcimit të pjesëmarrjes së publikut në punën e saj në mënyrë që të kontribuojë për një legjislacion më cilësor dhe në këtë mënyrë të rrit kapacitetin demokratik dhe besimin në Kuvend.

IV. REKOMANDIME PËR KUVENDIN E MAQEDONISË PËR PËRMIRËSIMIN E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PUNËN E SAJ

IV.1. Për të përgatiten udhëzime lehtë të arritshme dhe të inkurajojë

pjesëmarrjen e publikut në punën e Kuvendit – në këtë mënyrë qytetaret dhe palët e interesuara do ta kenë më lehtë për të kuptuar instruksionet se si të marrin pjesë në punën e Kuvendit dhe do të inkurajohen që të angazhohen më shumë;

IV.2. Deputetet shpesh duhet të kontaktojnë dhe të takohet me qytetaret në Kuvend, zyrat për kontakt me qytetaret dhe në vende tjera në njësitë zgjedhore - kjo do të rrisë ndërgjegjësimin e qytetareve për atë se kush janë deputetet e tyre, do të forcojë lidhjen mes qytetareve dhe deputeteve përkatëse, do të ndikojë pozitivisht në përgjegjësinë e deputeteve ndaj qytetareve, ndaj të kuptuarit dhe përfaqësimit të pikpamjeve të tyre. Së fundi, ajo do të kontribuojë në rritjen e besimit ndaj Kuvendit, gjë që do ta rrit besimin e përgjithshëm ndaj asaj se si udhëhiqet shteti;

IV.3. Të publikohet thirrje të hapur për të dhënat, në seancat e komisioneve, dëgjimeve publike dhe mbikëqyrëse dhe ato të jenë të hapura për pjesmarrje parrregullën “vetëm me ftesë” - kjo do të sigurojë një kanal të hapur për hulumtim, të dhëna dhe analiza nga të gjithë të interesuarit që do të jetë e dobishme për Kuvendin dhe do të përmirësojë cilësinë e legjislacionit. Thirrja e hapura për të dhëna, tw cilat më pas gjerësisht do të informojnë për diskutime të veçanta, duhet të shpallet të paktën një ose dy javë më herët kështu që çdo veprimtarja e jashtme të jetë në gjendje të përgatis dhe të dorëzojë përfundimet e saj. Pjesëmarrja e publikut në seanca, dëgjime publike dhe mbikëqyrëse duhet të jetë e hapur për të gjithë ata që mund të kontribuojnë dhe nuk duhet të kufizohet nga rregulli “vetëm me ftesë”;

IV.4. Të futen ndryshime ligjore në mënyrë që të jenë në gjendje të paraqesin peticione publike dhe e-peticione edhe në Kuvendin e Maqedonisë - kjo do tu lejojë qytetareve të ndikojnë në vendim-marrje midis dy zgjedhjeve parlamentare dhe

të kenë qasje më të lehtë në Kuvend ku do të mund të dëgjohet zëri i tyre;

IV.5. Për të siguruar mundësinë e qytetareve personalisht të marrin pjesë në seancat e Kuvendit dhe ti vëzhgojnë ato - kjo do tu sigurojë qytetareve personalisht ti ndjekin debatet në Kuvend, vendimmarrjet demokratike dhe deputetet e tyre. Vizitat e seancave plenare mund të organizohen lehtë për vizitorët në bazë të parimit i pari në rend - i pari për të hyrë dhe marrë pjesë për kohë të kufizuar në seancë;

IV.6. Të organizojë takime të strukturuar tematike midis deputeteve dhe organizatave të shoqërisë civile në modelin e seancave të Agorës së Parlamentit Evropian - kjo do ti mundësojë Kuvendit të ketë qasje më të madhe në hulumtime dhe analiza të shoqërisë civile, të jetë më i informuar për punën e shoqërisë civile, të kenë dialog me shoqërinë civile dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në forcimin e demokratizimit të vendit;

IV.7. Të përforcohet shpërndarja e informacioneve mbi punën e Kuvendit nëpërmjet profileve të Kuvendit në rrjetet sociale - në këtë mënyrë Kuvendi do të përdorë mediat e reja për të forcuar kontaktet e saj me qytetaret dhe ato do të jenë më të informuara në lidhje me krijimin e politikave dhe vendim-marrje;

IV.8. Të vendosen inqizimet e seancave plenare dhe komisioneve në kanal zyrtar të Kuvendit në YouTube - kjo do të sigurojë një kanal tjetër të arritshëm që qytetaret të njoftohen drejtpërdrejt me punën e Kuvendit dhe do të sigurojë qasje të lehtë për watch-dog dhe dhe aktivitete kërkimore.